



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 1797 Prot

Tiranë, më 27.12.2019

V E N D I M

Nr.207, datë 27.12.2019

“Mbi përfundimin e verifikimit të kryer në institucionin e qeverisjes vendore Bashkia Gjirokastrë, të filluar me urdhrin nr. 65, datë 12.9.2019, të Komisionerit”, në lidhje me evidentimin e rasteve të emërimeve në kundërshtim me ligjin në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil, si dhe zbatimin e standardeve ligjore në strukturimin e shërbimit civil, në përputhje me parimet e ligjit për nëpunësin civil në këtë bashki.

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit në lidhje me verifikimin e kryer në njësinë e vetëqeverisjes vendore Bashkia Gjirokastrë,

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me qëllim mbikëqyrjen e zbatimit të ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në lidhje me emërimet në shërbimin civil, si dhe zbatimin e standardeve ligjore në strukturimin e shërbimit civil, me urdhrin nr. 65, datë 12.9.2019 “Për fillimin e procesit të inspektimit në lidhje me rastet e emërimeve në kundërshtim me ligjin në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil në njësitë e vetëqeverisjes vendore, si dhe verifikimi i zbatimit të standardeve ligjore në strukturimin e shërbimit civil, si pjesë e rëndësishme e strukturës organizative të institucionit në përputhje me parimet e ligjit për nëpunësin civil”, ka nisur kryesisht procesin e verifikimit në të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore (61 bashkitë e vendit), ku përfshihet edhe Bashkia Gjirokastrë.

Verifikimi u realizua nëpërmjet vizitës në subjekt nga grupi i inspektimit, i autorizuar nga Komisioneri për këtë qëllim. Nga aktet e administruara gjatë inspektimit në subjekt, ka rezultuar se, Bashkia Gjirokastrë, është e organizuar dhe funksionon në bazë të strukturës

dhe organikës të miratuar me urdhrin nr. 19, datë 16.01.2019, të Kryetarit të Bashkisë Gjirokastër, “Për miratimin e strukturës së administratës së Bashkisë dhe të njëjësive shpenzuese në varësi të Bashkisë Gjirokastër për vitin 2019”, strukturë e cila është në fuqi edhe në momentin e kryerjes së verifikimit.

Sipas kësaj strukture, Bashkia Gjirokastër së bashku me njësitë administrative dhe agjencitë në përbërje të saj, ka gjithsej **123** pozicione pune të vlerësuara si pjesë e shërbimit civil, të cilat sipas kategorive të shërbimit civil klasifikohen: **1** pozicion i nivelit të lartë drejtues, **10** pozicione të kategorisë së mesme drejtuese, **23** pozicione të kategorisë së ulët drejtuese dhe **89** pozicione të kategorisë ekzekutive.

Në strukturën organizative të Bashkisë Gjirokastër, Komisioneri ka evidentuar pozicione pune, të cilat për nga emërtesa konsiderohen si pozicione të shërbimit civil, për faktin se në strukturë shoqërohen me emërtesën “*Specialist*” ose “*Inspektor*”. Konstatohet se këto pozicione, pavarësisht emërtesës, janë trajtuar nga njësia përgjegjëse si funksione administrative, jashtë shërbimit civil, nisur nga kompetencat dhe detyrat funksionale që ato kryejnë, si dhe kategoria e pagës aplikuar për këto pozicione.

Nga ana tjetër, Komisioneri konstaton se, në strukturën aktuale të Bashkisë Gjirokastër përfshihen 5 agjenci, konkretisht “*Agjencia e të Ardhurave*”, “*Agjencia e Mirëqënies dhe Kujdesit Social*”, “*Agjencia e Shërbimeve Publike*”, “*Agjencia e Kulturës, Turizmit, Trashëgimisë dhe Sportit*” dhe “*Agjencia e Shërbimeve Bujqësore, Veterinere dhe Mjedisore*”, struktura të cilat në zbatim të detyrave të lëna në vendimin paralajmërues të Komisionerit, janë përfshirë në skemën e shërbimit civil.

Megjithatë, në këto struktura evidentohen problematika në klasifikimin e pozicioneve të shërbimit civil, të cilat gjejnë pasqyrim jo vetëm në mënyrën e emërtesës së pozicioneve, por dhe në kategorinë e pagës së aplikuar për to. Konkretisht, Komisioneri konstaton se, një pjesë konsideruese e pozicioneve që përfshihen në strukturën e agjencive, trajtohen nga njësia përgjegjëse si pozicione të shërbimit civil (*nisur kjo dhe nga kategoria e pagës së aplikuar*), por nuk rezultojnë të jenë emërtuar sipas kërkesave të nenit 19, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar.

Njëkohësisht, konstatohet se, çdo agjenci ka në përberje të strukturës së saj njësinë organizative, e cila kryen funksionet e burimeve njerëzore. Ky fakt, përbën një pengesë në ushtrimin e kompetencave ligjore nga ana e njësië së menaxhimit të burimeve njerëzore, pjesë e administratës së bashkisë, e cila në kuptim të nenit 4, pika 1, germa “f”, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, përbën njësinë përgjegjëse për institucionet e vëteqeverisjes vendore.

Në këto kushte, më qëllim krijimin e një strukture efektive, në funksion të shërbimit civil, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të Bashkisë Gjirokastër, me miratimin e strukturës së ardhshme për vitin 2020, pozicionet e punës, të cilat kryejnë funksione administrative, nuk duhet të shoqërohen me emërtesën “*Specialist*” ose “*Inspektor*”, me qëllim diferencimin e tyre nga pozicionet e shërbimit civil.

Më tej, në lidhje me pozicionet e punës, pjesë përbërëse e strukturës së agjencive, njësia përgjegjëse e Bashkisë Gjirokastër, me miratimin e strukturës së ardhshme, duhet të analizojë detyrat, funksionet dhe kompetencat përkatëse për këto pozicione, nëpërmjet procesit të hartimit të përshkrimeve të punës dhe në përfundim të këtij procesi të vendosë përfshirjen e këtyre pozicioneve ose jo, në skemën e shërbimit civil.

Në kuptim të dispozitave të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar dhe vendimit nr. 142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura*”, i ndryshuar, vlerësohet se trajtimi dhe përfshirja e një pozicioni pune në fushën e veprimit të ligjit për shërbimin civil, duhet të analizohet duke e lidhur me detyrat dhe funksionet e pozicionit konkret, kjo në referencë të ushtrimit të autoritetit publik, në drejtim të formulimit dhe zbatimit të politikave, monitorimin e zbatimit të procedurave administrative, sigurimin e ekzekutimit të tyre dhe ofrimit të mbështetjes së përgjithshme administrative për zbatimin e tyre.

Sa më sipër, njësia përgjegjëse e Bashkisë Gjirokastër, duhet të tregojë kujdes që pozicionet e punës, të cilat do të përfshihen në skemën e shërbimit civil, të emërtohen në përputhje me përcaktimet e nenit 19, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, dhe të shoqërohen me kategorinë e pagës, në përputhje me përcaktimet e vendimit nr. 165, datë 02.03.2016, të Këshillit të Ministrave, “*Për grupimin e Njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civil e punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore*”, i ndryshuar.

Njëkohësisht, me miratimin e strukturës së ardhshme, duhet të përcaktohen qartësisht funksionet dhe kompetencat e pozicioneve që ushtrojnë funksionet e burimeve njerëzore pranë agjencive, me qëllim garantimin dhe zbatimin e kompetencave ligjore që gëzon kjo njësi, në cilësinë e njësive përgjegjëse, në kuadër të administrimit të shërbimit civil.

Në përfundim të procesit të verifikimit në subjekt, u konstatua se **49** pozicione pune të shërbimit civil, janë plotësuar në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij; **66** pozicione të shërbimit civil, rezultojnë së aktualisht janë plotësuar me punonjës të emëruar me akt të përkohshëm emërimi apo kontrata të përkohshme, dhe jo sipas një procedure të rregullt konkurrimi, e cila është e

vetmja mënyrë për të plotësuar pozicionet e punës të kategorisë ekzekutive, ndërsa 8 pozicione të shërbimit civil rezultuan të lira.

Konkretisht, rastet e emërimeve në kundërshtim me ligjin evidentohen si më poshtë, ku specifikohet pozicioni i punës dhe punonjësi që kryen aktualisht detyrën, si edhe akti i emërimit i nxjerrë nga titullari i institucionit:

1. *****, “*Sekretar, protokoll-arkiv*”, në Njësinë Administrative Lazarat, emëruar me urdhrin nr. 254, datë 15.04.2016;
2. *****, “*Sekretar, protokoll-arkiv*”, në Njësinë Administrative Çepo, emëruar me urdhrin nr. 169, datë 05.04.2016;
3. *****, “*Sekretar, protokoll-arkiv*”, në Njësinë Administrative Picar, emëruar me urdhrin nr. 61, datë 31.01.2019;
4. *****, “*Sekretar, protokoll-arkiv*”, në Njësinë Administrative Antigone, emëruar me urdhrin nr. 350, datë 24.10.2018;
5. *****, “*Sekretar, protokoll-arkiv*”, në Njësinë Administrative Odrije, emëruar me urdhrin nr. 288, datë 06.09.2018;
6. *****, “*Sekretar, protokoll-arkiv*”, në Njësinë Administrative Lunxheri, emëruar me urdhrin nr. 166, datë 05.04.2016;
7. *****, “*Përgjegjës i Sektorit të Ndihmës Ekonomike*”, në Drejtorinë e Shërbimeve Sociale, emëruar me urdhrin nr. 112, datë 23.03.2016;
8. *****, “*Specialist i PAK*”, në Sektorin e Ndihmës Ekonomike, në Drejtorinë e Shërbimeve Sociale, emëruar me urdhrin nr. 104, datë 23.03.2016;
9. *****, “*Specialist i ndihmës ekonomike*”, në Sektorin e Ndihmës Ekonomike, në Drejtorinë e Shërbimeve Sociale, emëruar me urdhrin nr. 171, datë 05.04.2016;
10. *****, “*Specialist i vlerësimit të nevojave dhe referim rasti*”, në Njësinë e Mbrojtjes Sociale dhe Fëmijëve, në Drejtorinë e Shërbimeve Sociale, emëruar me urdhrin nr. 168, datë 05.04.2016;
11. *****, “*Inspektor terreni*”, në Sektorin e Tatim Taksave, në Agjencinë e të Ardhurave, emëruar me urdhrin nr. 269, datë 22.04.2016;
12. *****, “*Inspektor terreni*”, në Sektorin e Tatim Taksave, në Agjencinë e të Ardhurave, emëruar me urdhrin nr. 96, datë 23.03.2016;
13. *****, “*Inspektor terreni*”, në Sektorin e Tatim Taksave, në Agjencinë e të Ardhurave, emëruar me urdhrin nr. 99, datë 23.03.2016;
14. *****, “*Inspektor terreni*”, në Sektorin e Tatim Taksave, në Agjencinë e të Ardhurave, emëruar me urdhrin nr. 100, datë 23.03.2016;
15. *****, “*Inspektor terreni*”, në Sektorin e Tatim Taksave, në Agjencinë e të Ardhurave, emëruar me urdhrin nr. 107, datë 23.03.2016;
16. *****, “*Inspektor terreni*”, në Sektorin e Tatim Taksave, në Agjencinë e të Ardhurave, emëruar me urdhrin nr. 106, datë 23.03.2016;

17. *****, “*Inspektor terreni*”, në Sektorin e Tatim Taksave, në Agjencinë e të Ardhurave, emëruar me urdhrin nr. 174, datë 05.04.2016;
18. *****, “*Inspektor për vjeljen e taksave*”, në Sektorin e Tatim Taksave, në Agjencinë e të Ardhurave, emëruar me urdhrin nr. 113, datë 23.03.2016;
19. *****, “*Inspektor për vjeljen e taksave*”, në Sektorin e Tatim Taksave, në Agjencinë e të Ardhurave, emëruar me urdhrin nr. 173, datë 05.04.2016;
20. *****, “*Inspektor për vjeljen e taksave*”, në Sektorin e Tatim Taksave, në Agjencinë e të Ardhurave, emëruar me urdhrin nr. 175, datë 05.04.2016;
21. *****, “*Inspektor për vjeljen e taksave*”, në Sektorin e Tatim Taksave, në Agjencinë e të Ardhurave, emëruar me urdhrin nr. 170, datë 05.04.2016;
22. *****, “*Inspektor për vjeljen e taksave*”, në Sektorin e Tatim Taksave, në Agjencinë e të Ardhurave, emëruar me urdhrin nr. 197/1, datë 31.05.2018;
23. *****, “*Inspektor për vjeljen e taksave*”, në Sektorin e Tatim Taksave, në Agjencinë e të Ardhurave, emëruar me urdhrin nr. 342, datë 12.10.2018;
24. *****, “*Inspektor tregu pakice*”, në Sektorin e Tregjeve dhe Parkingjeve, në Agjencinë e të Ardhurave, emëruar me urdhrin nr. 114, datë 23.03.2016;
25. *****, “*Përgjegjës Sektori*”, në Sektorin e Menaxhimit të Pronave, në Agjencinë e të Ardhurave, emëruar me urdhrin nr. 313, datë 06.05.2016;
26. *****, “*Specialist i menaxhimit të pronave*”, në Sektorin e Menaxhimit të Pronave, në Agjencinë e të Ardhurave, emëruar me urdhrin nr. 105, datë 23.03.2016;
27. *****, “*Specialist i menaxhimit të pronave*”, në Sektorin e Menaxhimit të Pronave, në Agjencinë e të Ardhurave, emëruar me urdhrin nr. 295, datë 27.04.2016;
28. *****, “*Specialist*”, në Sektorin e Menaxhimit të Pronave, në Agjencinë e të Ardhurave, emëruar me urdhrin nr. 26, datë 06.02.2017;
29. *****, “*Përgjegjës Sektori*”, në Sektorin e Financës, në Agjencinë e Mirëqënies dhe Kujdesit Social, emëruar me urdhrin nr. 108, datë 10.04.2017;
30. *****, “*Specialist finance*”, në Sektorin e Financës, në Agjencinë e Mirëqënies dhe Kujdesit Social, emëruar me urdhrin nr. 381, datë 25.09.2019;
31. *****, “*Specialist finance*”, në Sektorin e Financës, në Agjencinë e Mirëqënies dhe Kujdesit Social, emëruar me urdhrin nr. 257, datë 27.07.2018;
32. *****, “*Arkëtare*”, në Sektorin e Financës, në Agjencinë e Mirëqënies dhe Kujdesit Social, emëruar me urdhrin nr. 334, datë 30.08.2019;
33. *****, “*Llogaritar*”, në Sektorin e Financës, në Agjencinë e Mirëqënies dhe Kujdesit Social, emëruar me urdhrin nr. 358, datë 10.09.2019;
34. *****, “*Jurist*”, në Sektorin e Financës, në Agjencinë e Mirëqënies dhe Kujdesit Social, emëruar me urdhrin nr. 10, datë 14.10.2019;
35. *****, “*Përgjegjës Sektori*”, në Sektorin e Mirëmbajtjes, në Agjencinë e Mirëqënies dhe Kujdesit Social, emëruar me urdhrin nr. 173 prot., datë 17.03.2017;
36. *****, “*Përgjegjës Sektori*”, në Sektorin e Burimeve Njerëzore, në Agjencinë e Mirëqënies dhe Kujdesit Social, emëruar me urdhrin nr. 357, datë 10.09.2019;

37. *****, “*Specialist protokoll*”, në Sektorin e Burimeve Njerëzore, në Agjencinë e Mirëqënies dhe Kujdesit Social, emëruar me urdhrin nr. 9, datë 14.10.2019;
38. *****, “*Drejtor*”, në Agjencinë e Kulturës, Turizmit, Trashëgimisë dhe Sportit, emëruar me urdhrin nr. 277, datë 25.04.2016;
39. *****, “*Specialist i burimeve njerëzore*”, në Agjencinë e Kulturës, Turizmit, Trashëgimisë dhe Sportit, emëruar me urdhrin nr. 55, datë 08.03.2017;
40. *****, “*Përgjegjës Sektori*”, në Sektorin e Financës, në Agjencinë e Kulturës, Turizmit, Trashëgimisë dhe Sportit (mungon akti i emërimit);
41. *****, “*Specialist finance*”, në Sektorin e Financës, në Agjencinë e Kulturës, Turizmit, Trashëgimisë dhe Sportit, emëruar me urdhrin nr. 67, datë 06.02.2019;
42. *****, “*Llogaritar*”, në Sektorin e Financës, në Agjencinë e Kulturës, Turizmit, Trashëgimisë dhe Sportit, emëruar me urdhrin nr. 193, datë 11.04.2016;
43. *****, “*Jurist*”, në Sektorin e Menaxhimit të Administratës, në Agjencinë e Shërbimeve Bujqësore, Veterinere dhe Mjedisore, emëruar me urdhrin nr. 23, datë 31.01.2017;
44. *****, “*Financier*”, në Sektorin e Menaxhimit të Administratës, në Agjencinë e Shërbimeve Bujqësore, Veterinere dhe Mjedisore, emëruar me urdhrin nr. 458, datë 01.09.2016;
45. *****, “*Përgjegjës Sektori*”, në Sektorin e Pyjeve, Kullotave dhe Mjedisit, në Agjencinë e Shërbimeve Bujqësore, Veterinere dhe Mjedisore, emëruar me urdhrin nr. 250, datë 11.04.2016;
46. *****, “*Specialist*”, në Sektorin e Pyjeve, Kullotave dhe Mjedisit, në Agjencinë e Shërbimeve Bujqësore, Veterinere dhe Mjedisore, emëruar me urdhrin nr. 251, datë 11.04.2016;
47. *****, “*Specialist SAPK*”, në Sektorin e Pyjeve, Kullotave dhe Mjedisit, në Agjencinë e Shërbimeve Bujqësore, Veterinere dhe Mjedisore, emëruar me urdhrin nr. 252, datë 11.04.2016;
48. *****, “*Inspektor terreni*”, në Sektorin e Pyjeve, Kullotave dhe Mjedisit, në Agjencinë e Shërbimeve Bujqësore, Veterinere dhe Mjedisore, emëruar me urdhrin nr. 174, datë 14.05.2018;
49. *****, “*Specialist SAPK*”, në Sektorin e Pyjeve, Kullotave dhe Mjedisit, në Agjencinë e Shërbimeve Bujqësore, Veterinere dhe Mjedisore, emëruar me urdhrin nr. 527, datë 02.11.2016;
50. *****, “*Inspektor terreni SAPK*”, në Sektorin e Pyjeve, Kullotave dhe Mjedisit, në Agjencinë e Shërbimeve Bujqësore, Veterinere dhe Mjedisore, emëruar me urdhrin nr. 266, datë 22.04.2016;
51. *****, “*Inspektor terreni SAPK*”, në Sektorin e Pyjeve, Kullotave dhe Mjedisit, në Agjencinë e Shërbimeve Bujqësore, Veterinere dhe Mjedisore, emëruar me urdhrin nr. 293, datë 27.04.2016;

52. *****, “*Inspektor terreni SAPK*”, në Sektorin e Pyjeve, Kullotave dhe Mjedisit, në Agjencinë e Shërbimeve Bujqësore, Veterinere dhe Mjedisore, emëruar me urdhrin nr. 294, datë 27.04.2016;
53. *****, “*Përgjegjës Sektori*”, në Sektorin e Bujqësisë, Ujitjes, Kullimit dhe Veterinarisë, në Agjencinë e Shërbimeve Bujqësore, Veterinere dhe Mjedisore, emëruar me urdhrin nr. 343, datë 12.12.2017;
54. *****, “*Inspektor kullimi*”, në Sektorin e Bujqësisë, Ujitjes, Kullimit dhe Veterinarisë, në Agjencinë e Shërbimeve Bujqësore, Veterinere dhe Mjedisore, emëruar me urdhrin nr. 288, datë 26.04.2016;
55. *****, “*Specialist kullimi*”, në Sektorin e Bujqësisë, Ujitjes, Kullimit dhe Veterinarisë, në Agjencinë e Shërbimeve Bujqësore, Veterinere dhe Mjedisore, emëruar me urdhrin nr. 267, datë 22.04.2016;
56. *****, “*Veteriner SKUBV*”, në Sektorin e Bujqësisë, Ujitjes, Kullimit dhe Veterinarisë, në Agjencinë e Shërbimeve Bujqësore, Veterinere dhe Mjedisore, emëruar me urdhrin nr. 272, datë 22.04.2016;
57. *****, “*Specialist bujqësie*”, në Sektorin e Bujqësisë, Ujitjes, Kullimit dhe Veterinarisë, në Agjencinë e Shërbimeve Bujqësore, Veterinere dhe Mjedisore, emëruar me urdhrin nr. 271, datë 22.04.2016;
58. *****, “*Veteriner*”, në Sektorin e Bujqësisë, Ujitjes, Kullimit dhe Veterinarisë, në Agjencinë e Shërbimeve Bujqësore, Veterinere dhe Mjedisore, emëruar me urdhrin nr. 313/1, datë 06.05.2016;
59. *****, “*Specialist veteriner*”, në Sektorin e Bujqësisë, Ujitjes, Kullimit dhe Veterinarisë, në Agjencinë e Shërbimeve Bujqësore, Veterinere dhe Mjedisore, emëruar me urdhrin nr. 57, datë 31.01.2019;
60. *****, “*Specialist agronom*”, në Sektorin e Bujqësisë, Ujitjes, Kullimit dhe Veterinarisë, në Agjencinë e Shërbimeve Bujqësore, Veterinere dhe Mjedisore, emëruar me urdhrin nr. 56, datë 31.07.2019;
61. *****, “*Drejtor*”, në Agjencinë e Shërbimeve Publike, emëruar me urdhrin nr. 271, datë 06.08.2019;
62. *****, “*Përgjegjës Finance*”, në Agjencinë e Shërbimeve Publike, emëruar me urdhrin nr. 276, datë 16.09.2015;
63. *****, “*Kontabilist*”, në Agjencinë e Shërbimeve Publike, emëruar me urdhrin nr. 181, datë 06.04.2016;
64. *****, “*Specialist i burimeve njerëzore*”, në Agjencinë e Shërbimeve Publike, emëruar me urdhrin nr. 199, datë 03.07.2017;
65. *****, “*Arshiv-magaziniere*”, në Agjencinë e Shërbimeve Publike, emëruar me urdhrin nr. 382, datë 10.11.2015;
66. *****, “*Specialist i marrëdhënieve me publikun*”, në Agjencinë e Shërbimeve Publike, emëruar me urdhrin nr. 205, datë 05.06.2018.

Komisioneri konstaton se, aktet e mësipërme të emërimit, kanë dalë në kundërshtim me ligjin, pasi, për çdo marrëdhënie të re pune, që lidhet pas fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, në bazë të nenit 22, 23, 25 dhe 26 të tij, duhet të respektohen detyrimisht kërkesat e një procedure të rregullt konkurrimi. *Çdo emërim që bëhet në kundërshtim me këtë rregull, është absolutisht i pavlefshëm.*

Vërejmë se, duke vepruar në këtë mënyrë, titullari i institucionit, ka vepruar në kundërshtim me procedurën e nxjerrjes së aktit, referuar parashikimeve të legjislacionit në fuqi, ç’ka në vështrim të nenit 108, pikat i) dhe ii) të shkronjës “a” dhe shkronjës “ç”, të ligjit nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i RSH”*, i bën aktet absolutisht të pavlefshëm.

Për më tepër, ndalimi i emërimit në kundërshtim me procedurën, është theksuar shprehimisht në pikën 4, të nenit 23, të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, për të mos lejuar subjektivitet apo keqinterpretime në implementimin e kësaj dispozite në praktikë. Në vijim të këtij arsytimi, në bazë të nenit 110, pika 1, të ligjit nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i RSH”*, veprimi administrativ absolutisht i pavlefshëm nuk sjell asnjë pasojë juridike, pavarësisht faktit nëse është konstatuar apo jo si i tillë.

Nisur nga detyrimi i parashikuar nga neni 111, i ligjit në fjalë, vetë organi publik, në këtë rast Kryetari i Bashkisë Gjirokastër, duhet të konstatojë në këto veprime administrative, ekzistencën e rasteve të parashikuara në nenin 108, të ligjit si më lart, dhe në bazë të pikës 1, të nenit 111, të po këtij ligji, të konstatojë menjëherë pavlefshmërinë absolute të këtyre akteve dhe të rregullojë pasojat duke ndërprerë marrëdhënien e punës të lidhur në kundërshtim me procedurat ligjore dhe më tej, duke i shpallur si të lira këto pozicione, për t’u plotësuar në përputhje me ligjin për nëpunësin civil.

Pozicionet në fjalë, duhet të plotësohen me anën e procedurave të konkurrimit të hapur, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, dhe akteve nënligjore dalë për zbatim të tij, apo nëpërmjet procedurave të lëvizjes paralele dhe të ngritjes në detyrë.

Njësia përgjegjëse, gjatë zhvillimit të procedurave të konkurrimit, duhet të kujdeset të përmbushë rregullat e përcaktuara në kreun IV *“Pranimi në shërbim civil”*, të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, vendimin nr. 242, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave *“Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”* dhe vendimin nr. 243, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave, *“Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”*, si dhe udhëzimin nr. 2, datë 27.3.2015, të Departamentit të Administratës Publike *“Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele,*

ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur”.

Në kushtet kur, pranë këtij institucioni është një numër relativisht i lartë i pozicioneve të punës në nivelin ekzekutiv për t’u plotësuar nëpërmjet konkurrimit, duhen të mbahen parasysh kërkesat e pikës 8, të nenit 19, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, për të realizuar konkurrimet në grupet e pozicioneve të administrimit të posaçëm dhe grupet e pozicioneve të administrimit të përgjithshëm.

Gjatë verifikimit të ligjshmërisë në institucion është evidentuar edhe rasti i punonjësit ***** me detyrë “*Sekretar i Përgjithshëm*”, në Bashkinë Gjirokastrë, i cili gjatë ushtrimit të funksioneve të nëpunësit civil, ka ushtruar njëkohësisht funksionet e Kryetarit të Partisë, “*Lëvizja Socialiste për Integritim*”, për Qarkun Gjirokastrë. Komisioneri vlerëson se, ky veprim bie ndesh me parimet bazë të sjelljes së nëpunësit civil, si dhe me përcaktimet e nenit 37, pika 2, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, në të cilin përcaktohet në mënyrë eksplicite se: “*Nëpunësit civilë të nivelit të lartë drejtues nuk mund të jenë anëtar të partive politike*”.

Në kushtet kur, kryerja e veprimeve apo sjelljeve që vijnë në kundërshtim me urdhërimin e dispozitës së mësipërme, konsiderohet thyerje e rëndë e disiplinës, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të Bashkisë Gjirokastrë duhet të marrë masa për fillimin e ecurisë disiplinore ndaj nëpunësit ***** me detyrë “*Sekretar i Përgjithshëm*”, duke ngritur Komisionin Disiplinor, si organ kompetent për shqyrtimin e kësaj shkelje disiplinore.

Njëkohësisht, nisur nga fakti që, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të Bashkisë Gjirokastrë nuk ka informuar grupin e monitorimit (*pranë KMSHC*) për këtë fakt gjatë procesit të monitorimit të sjelljes së nëpunësit civil gjatë fushatës zgjedhore për organet e qeverisjes vendore (*qershor 2019*), Komisioneri kërkon të sjellë në vëmendje të njësisë së menaxhimit të burimeve njerëzore detyrimin ligjor të kryerjes së detyrave të saj me përgjegjshmëri, profesionalizëm, paanësi dhe në përputhje të plotë me përcaktimet e ligjit për shërbimin civil.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, referuar Seksionit III, “*Procedura hetimore*”, të ligjit nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”, si dhe Rregullores “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

V E N D O S A:

1. Me synim rregullimin e situatës së ligjshmërisë së administrimit të shërbimit civil, të kërkoj nga Kryetari i Bashkisë Gjirokastër, të konstatojë si akte administrative absolutisht të pavlefshëm, **66** rastet e emërimit të punonjësve në kundërshtim me ligjin në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil, që janë:

- ✓ ***** , “*Sekretar, protokoll-arkiv*”, në Njësinë Administrative Lazarat, emëruar me urdhrin nr. 254, datë 15.04.2016;
- ✓ ***** , “*Sekretar, protokoll-arkiv*”, në Njësinë Administrative Çepo, emëruar me urdhrin nr. 169, datë 05.04.2016;
- ✓ ***** , “*Sekretar, protokoll-arkiv*”, në Njësinë Administrative Picar, emëruar me urdhrin nr. 61, datë 31.01.2019;
- ✓ ***** , “*Sekretar, protokoll-arkiv*”, në Njësinë Administrative Antigone, emëruar me urdhrin nr. 350, datë 24.10.2018;
- ✓ ***** , “*Sekretar, protokoll-arkiv*”, në Njësinë Administrative Odrije, emëruar me urdhrin nr. 288, datë 06.09.2018;
- ✓ ***** , “*Sekretar, protokoll-arkiv*”, në Njësinë Administrative Lunxheri, emëruar me urdhrin nr. 166, datë 05.04.2016;
- ✓ ***** , “*Përgjegjës i Sektorit të Ndihmës Ekonomike*”, në Drejtorinë e Shërbimeve Sociale, emëruar me urdhrin nr. 112, datë 23.03.2016;
- ✓ ***** , “*Specialist i PAK*”, në Sektorin e Ndihmës Ekonomike, në Drejtorinë e Shërbimeve Sociale, emëruar me urdhrin nr. 104, datë 23.03.2016;
- ✓ ***** , “*Specialist i ndihmës ekonomike*”, në Sektorin e Ndihmës Ekonomike, në Drejtorinë e Shërbimeve Sociale, emëruar me urdhrin nr. 171, datë 05.04.2016;
- ✓ ***** , “*Specialist i vlerësimit të nevojave dhe referim rasti*”, në Njësinë e Mbrojtjes Sociale dhe Fëmijëve, në Drejtorinë e Shërbimeve Sociale, emëruar me urdhrin nr. 168, datë 05.04.2016;
- ✓ ***** , “*Inspektor terreni*”, në Sektorin e Tatim Taksave, në Agjencinë e të Ardhurave, emëruar me urdhrin nr. 269, datë 22.04.2016;
- ✓ ***** , “*Inspektor terreni*”, në Sektorin e Tatim Taksave, në Agjencinë e të Ardhurave, emëruar me urdhrin nr. 96, datë 23.03.2016;
- ✓ ***** , “*Inspektor terreni*”, në Sektorin e Tatim Taksave, në Agjencinë e të Ardhurave, emëruar me urdhrin nr. 99, datë 23.03.2016;
- ✓ ***** , “*Inspektor terreni*”, në Sektorin e Tatim Taksave, në Agjencinë e të Ardhurave, emëruar me urdhrin nr. 100, datë 23.03.2016;
- ✓ ***** , “*Inspektor terreni*”, në Sektorin e Tatim Taksave, në Agjencinë e të Ardhurave, emëruar me urdhrin nr. 107, datë 23.03.2016;
- ✓ ***** , “*Inspektor terreni*”, në Sektorin e Tatim Taksave, në Agjencinë e të Ardhurave, emëruar me urdhrin nr. 106, datë 23.03.2016;

- ✓ ***** , “*Inspektor terreni*”, në Sektorin e Tatim Taksave, në Agjencinë e të Ardhurave, emëruar me urdhrin nr. 174, datë 05.04.2016;
- ✓ ***** , “*Inspektor për vjeljen e taksave*”, në Sektorin e Tatim Taksave, në Agjencinë e të Ardhurave, emëruar me urdhrin nr. 113, datë 23.03.2016;
- ✓ ***** , “*Inspektor për vjeljen e taksave*”, në Sektorin e Tatim Taksave, në Agjencinë e të Ardhurave, emëruar me urdhrin nr. 173, datë 05.04.2016;
- ✓ ***** , “*Inspektor për vjeljen e taksave*”, në Sektorin e Tatim Taksave, në Agjencinë e të Ardhurave, emëruar me urdhrin nr. 175, datë 05.04.2016;
- ✓ ***** , “*Inspektor për vjeljen e taksave*”, në Sektorin e Tatim Taksave, në Agjencinë e të Ardhurave, emëruar me urdhrin nr. 170, datë 05.04.2016;
- ✓ ***** , “*Inspektor për vjeljen e taksave*”, në Sektorin e Tatim Taksave, në Agjencinë e të Ardhurave, emëruar me urdhrin nr. 197/1, datë 31.05.2018;
- ✓ ***** , “*Inspektor për vjeljen e taksave*”, në Sektorin e Tatim Taksave, në Agjencinë e të Ardhurave, emëruar me urdhrin nr. 342, datë 12.10.2018;
- ✓ ***** , “*Inspektor tregu pakice*”, në Sektorin e Tregjeve dhe Parkingjeve, në Agjencinë e të Ardhurave, emëruar me urdhrin nr. 114, datë 23.03.2016;
- ✓ ***** , “*Përgjegjës Sektori*”, në Sektorin e Menaxhimit të Pronave, në Agjencinë e të Ardhurave, emëruar me urdhrin nr. 313, datë 06.05.2016;
- ✓ ***** , “*Specialist i menaxhimit të pronave*”, në Sektorin e Menaxhimit të Pronave, në Agjencinë e të Ardhurave, emëruar me urdhrin nr. 105, datë 23.03.2016;
- ✓ ***** , “*Specialist i menaxhimit të pronave*”, në Sektorin e Menaxhimit të Pronave, në Agjencinë e të Ardhurave, emëruar me urdhrin nr. 295, datë 27.04.2016;
- ✓ ***** , “*Specialist*”, në Sektorin e Menaxhimit të Pronave, në Agjencinë e të Ardhurave, emëruar me urdhrin nr. 26, datë 06.02.2017;
- ✓ ***** , “*Përgjegjës Sektori*”, në Sektorin e Financës, në Agjencinë e Mirëqënies dhe Kujdesit Social, emëruar me urdhrin nr. 108, datë 10.04.2017;
- ✓ ***** , “*Specialist finance*”, në Sektorin e Financës, në Agjencinë e Mirëqënies dhe Kujdesit Social, emëruar me urdhrin nr. 381, datë 25.09.2019;
- ✓ ***** , “*Specialist finance*”, në Sektorin e Financës, në Agjencinë e Mirëqënies dhe Kujdesit Social, emëruar me urdhrin nr. 257, datë 27.07.2018;
- ✓ ***** , “*Arkëtare*”, në Sektorin e Financës, në Agjencinë e Mirëqënies dhe Kujdesit Social, emëruar me urdhrin nr. 334, datë 30.08.2019;
- ✓ ***** , “*Llogaritar*”, në Sektorin e Financës, në Agjencinë e Mirëqënies dhe Kujdesit Social, emëruar me urdhrin nr. 358, datë 10.09.2019;
- ✓ ***** , “*Jurist*”, në Sektorin e Financës, në Agjencinë e Mirëqënies dhe Kujdesit Social, emëruar me urdhrin nr. 10, datë 14.10.2019;
- ✓ ***** , “*Përgjegjës Sektori*”, në Sektorin e Mirëmbajtjes, në Agjencinë e Mirëqënies dhe Kujdesit Social, emëruar me urdhrin nr. 173 prot., datë 17.03.2017;

- ✓ *****, “Përgjegjës Sektori”, në Sektorin e Burimeve Njerëzore, në Agjencinë e Mirëqënies dhe Kujdesit Social, emëruar me urdhrin nr. 357, datë 10.09.2019;
- ✓ *****, “Specialist protokoll”, në Sektorin e Burimeve Njerëzore, në Agjencinë e Mirëqënies dhe Kujdesit Social, emëruar me urdhrin nr. 9, datë 14.10.2019;
- ✓ *****, “Drejtor”, në Agjencinë e Kulturës, Turizmit, Trashëgimisë dhe Sportit, emëruar me urdhrin nr. 277, datë 25.04.2016;
- ✓ *****, “Specialist i burimeve njerëzore”, në Agjencinë e Kulturës, Turizmit, Trashëgimisë dhe Sportit, emëruar me urdhrin nr. 55, datë 08.03.2017;
- ✓ *****, “Përgjegjës Sektori”, në Sektorin e Financës, në Agjencinë e Kulturës, Turizmit, Trashëgimisë dhe Sportit (mungon akti i emërimit);
- ✓ *****, “Specialist finance”, në Sektorin e Financës, në Agjencinë e Kulturës, Turizmit, Trashëgimisë dhe Sportit, emëruar me urdhrin nr. 67, datë 06.02.2019;
- ✓ *****, “Llogaritar”, në Sektorin e Financës, në Agjencinë e Kulturës, Turizmit, Trashëgimisë dhe Sportit, emëruar me urdhrin nr. 193, datë 11.04.2016;
- ✓ *****, “Jurist”, në Sektorin e Menaxhimit të Administratës, në Agjencinë e Shërbimeve Bujqësore, Veterinere dhe Mjedisore, emëruar me urdhrin nr. 23, datë 31.01.2017;
- ✓ *****, “Financier”, në Sektorin e Menaxhimit të Administratës, në Agjencinë e Shërbimeve Bujqësore, Veterinere dhe Mjedisore, emëruar me urdhrin nr. 458, datë 01.09.2016;
- ✓ *****, “Përgjegjës Sektori”, në Sektorin e Pyjeve, Kullotave dhe Mjedisit, në Agjencinë e Shërbimeve Bujqësore, Veterinere dhe Mjedisore, emëruar me urdhrin nr. 250, datë 11.04.2016;
- ✓ *****, “Specialist”, në Sektorin e Pyjeve, Kullotave dhe Mjedisit, në Agjencinë e Shërbimeve Bujqësore, Veterinere dhe Mjedisore, emëruar me urdhrin nr. 251, datë 11.04.2016;
- ✓ *****, “Specialist SAPK”, në Sektorin e Pyjeve, Kullotave dhe Mjedisit, në Agjencinë e Shërbimeve Bujqësore, Veterinere dhe Mjedisore, emëruar me urdhrin nr. 252, datë 11.04.2016;
- ✓ *****, “Inspektor terreni”, në Sektorin e Pyjeve, Kullotave dhe Mjedisit, në Agjencinë e Shërbimeve Bujqësore, Veterinere dhe Mjedisore, emëruar me urdhrin nr. 174, datë 14.05.2018;
- ✓ *****, “Specialist SAPK”, në Sektorin e Pyjeve, Kullotave dhe Mjedisit, në Agjencinë e Shërbimeve Bujqësore, Veterinere dhe Mjedisore, emëruar me urdhrin nr. 527, datë 02.11.2016;

- ✓ ***** , “*Inspektor terreni SAPK*”, në Sektorin e Pyjeve, Kullotave dhe Mjedisit, në Agjencinë e Shërbimeve Bujqësore, Veterinere dhe Mjedisore, emëruar me urdhrin nr. 266, datë 22.04.2016;
- ✓ ***** , “*Inspektor terreni SAPK*”, në Sektorin e Pyjeve, Kullotave dhe Mjedisit, në Agjencinë e Shërbimeve Bujqësore, Veterinere dhe Mjedisore, emëruar me urdhrin nr. 293, datë 27.04.2016;
- ✓ ***** , “*Inspektor terreni SAPK*”, në Sektorin e Pyjeve, Kullotave dhe Mjedisit, në Agjencinë e Shërbimeve Bujqësore, Veterinere dhe Mjedisore, emëruar me urdhrin nr. 294, datë 27.04.2016;
- ✓ ***** , “*Përgjegjës Sektori*”, në Sektorin e Bujqësisë, Ujitjes, Kullimit dhe Veterinarisë, në Agjencinë e Shërbimeve Bujqësore, Veterinere dhe Mjedisore, emëruar me urdhrin nr. 343, datë 12.12.2017;
- ✓ ***** , “*Inspektor kullimi*”, në Sektorin e Bujqësisë, Ujitjes, Kullimit dhe Veterinarisë, në Agjencinë e Shërbimeve Bujqësore, Veterinere dhe Mjedisore, emëruar me urdhrin nr. 288, datë 26.04.2016;
- ✓ ***** , “*Specialist kullimi*”, në Sektorin e Bujqësisë, Ujitjes, Kullimit dhe Veterinarisë, në Agjencinë e Shërbimeve Bujqësore, Veterinere dhe Mjedisore, emëruar me urdhrin nr. 267, datë 22.04.2016;
- ✓ ***** , “*Veteriner SKUBV*”, në Sektorin e Bujqësisë, Ujitjes, Kullimit dhe Veterinarisë, në Agjencinë e Shërbimeve Bujqësore, Veterinere dhe Mjedisore, emëruar me urdhrin nr. 272, datë 22.04.2016;
- ✓ ***** , “*Specialist bujqësie*”, në Sektorin e Bujqësisë, Ujitjes, Kullimit dhe Veterinarisë, në Agjencinë e Shërbimeve Bujqësore, Veterinere dhe Mjedisore, emëruar me urdhrin nr. 271, datë 22.04.2016;
- ✓ ***** , “*Veteriner*”, në Sektorin e Bujqësisë, Ujitjes, Kullimit dhe Veterinarisë, në Agjencinë e Shërbimeve Bujqësore, Veterinere dhe Mjedisore, emëruar me urdhrin nr. 313/1, datë 06.05.2016;
- ✓ ***** , “*Specialist veteriner*”, në Sektorin e Bujqësisë, Ujitjes, Kullimit dhe Veterinarisë, në Agjencinë e Shërbimeve Bujqësore, Veterinere dhe Mjedisore, emëruar me urdhrin nr. 57, datë 31.01.2019;
- ✓ ***** , “*Specialist agronom*”, në Sektorin e Bujqësisë, Ujitjes, Kullimit dhe Veterinarisë, në Agjencinë e Shërbimeve Bujqësore, Veterinere dhe Mjedisore, emëruar me urdhrin nr. 56, datë 31.07.2019;
- ✓ ***** , “*Drejtor*”, në Agjencinë e Shërbimeve Publike, emëruar me urdhrin nr. 271, datë 06.08.2019;
- ✓ ***** , “*Përgjegjës Finance*”, në Agjencinë e Shërbimeve Publike, emëruar me urdhrin nr. 276, datë 16.09.2015;
- ✓ ***** , “*Kontabilist*”, në Agjencinë e Shërbimeve Publike, emëruar me urdhrin nr. 181, datë 06.04.2016;
- ✓ ***** , “*Specialist i burimeve njerëzore*”, në Agjencinë e Shërbimeve Publike, emëruar me urdhrin nr. 199, datë 03.07.2017;

- ✓ ******, “*Arshiv-magaziniere*”, në Agjencinë e Shërbimeve Publike, emëruar me urdhrin nr. 382, datë 10.11.2015;
- ✓ ******, “*Specialist i marrëdhënieve me publikun*”, në Agjencinë e Shërbimeve Publike, emëruar me urdhrin nr. 205, datë 05.06.2018,

dhe të rregullohen pasojat duke i shpallur këto pozicione, për t’u plotësuar në përputhje me ligjin.

2. Njësia përgjegjëse, për pozicionet e shërbimit civil, të cilat rezultojnë të plotësuara në kundërshtim me ligjin, të shpallë konkurrimin për t’i plotësuar në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, si dhe në përputhje me strukturën e institucionit në momentin e ekzekutimit të vendimit paralajmërues të Komisionerit dhe më tej, të vijojë realizimi i procedurave të konkurrimit.
3. Njësia përgjegjëse, për pozicionet e nivelit ekzekutiv të realizojë procedurat e konkurrimit të hapur, duke mbajtur parasysh kërkesat e pikës 8, të nenit 19, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, me qëllim realizimin e konkurrimeve për grupet e pozicioneve të administrimit të posaçëm dhe grupet e pozicioneve të administrimit të përgjithshëm.
4. Institucioni të përgatitë dhe të miratojë deri në shkurt të vitit 2020, planin e nevojave për rekrutimin në shërbimin civil për vitin e ardhshëm, për pozicionet e mbetura vakant, duke respektuar procedurat dhe afatet e përcaktuara në vendimin nr. 108, datë 26.2.2014 të Këshillit të Ministrave, “*Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil*”.
5. Njësia përgjegjëse e Bashkisë Gjirokastrë, në momentin e miratimit të strukturës së ardhshme për vitin 2020, të tregoj kujdes në krijimin e një strukture, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, duke vepruar si më poshtë:
 - ✓ Të evitohet përdorimi e emërtesave “*Specialist*” ose “*Inspektor*”, për pozicione pune të cilat nuk përfshihen në skemën e shërbimit civil;
 - ✓ Të analizohet detyrat, funksionet dhe kompetencat përkatëse për pozicionet e punës, pjesë përbërëse e strukturës organizative të agjencive, nëpërmjet procesit të hartimit të përshkrimeve të punës dhe në përfundim të këtij procesi të vendosë përfshirjen e këtyre pozicioneve ose jo, në skemën e shërbimit civil;

- ✓ Pozicionet e punës, që do të trajtohen pjesë e shërbimit civil, të emërtohen në përputhje me përcaktimet e nenit 19, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, dhe të shoqërohen me kategorinë e pagës, në përputhje me përcaktimet e vendimit nr. 165, datë 02.03.2016, të Këshillit të Ministrave, “*Për grupimin e Njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civil e punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore*”, i ndryshuar.
 - ✓ Të analizojë dhe përcaktojë qartësisht detyrat dhe kompetencat e pozicioneve që ushtrojnë funksionet e burimeve njerëzore pranë agjencive, me qëllim garantimin dhe zbatimin e kompetencave ligjore që gëzon kjo njësi, në cilësinë e njësisë përgjegjëse, në kuadër të administrimit të shërbimit civil.
6. Njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të Bashkisë Gjirokastrë, të marrë masa për fillimin e ecurisë disiplinore ndaj nëpunësit *****, me detyrë “*Sekretar i Përgjithshëm*”, në zbatim të nenit 37, pika 2 dhe nenit 57, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar.
 7. Të përmbillet procesi i mbikëqyrjes, i cili është materializuar me vendimin paralajmërues nr. 11, datë 09.03.2018, të Komisionerit, “*Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në njësinë e vetëqeverisjes vendore bashkia Gjirokastrë dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë*” dhe të vijojë rregullimi i situatës ligjore në këtë subjekt sipas dispozitivit të vendimit paralajmërues për këtë institucion.
 8. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat **4 (katër) muaj** nga marrja dijani për këtë vendim. Institucioni i inspektuar dhe njësia përgjegjëse, duhet të zbatojnë këtë vendim, duke u bazuar në orientimet e dhëna në pjesën arsyetuese të tij. Me kalimin e këtij afati, subjekti i mbikëqyrur, njësia e vetëqeverisjes vendore Bashkia Gjirokastrë, duhet të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.
 9. Në rast të moszbatimit të këtij vendimi paralajmërues, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljeve të konstatuara, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjositjes së nëpunësit përgjegjës për mos zbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.
 10. Për këtë vendim të njoftohet Kryetari i Bashkisë Gjirokastrë, Njësia Përgjegjëse e Bashkisë Gjirokastrë, Ministria e Brendshme dhe Prefekti i Qarkut Gjirokastrë.

Njësia përgjegjëse e Bashkisë Gjirokastrë të njoftojë çdo punonjës që është i emëruar në kundërshtim me ligjin dhe që është i evidentuar në këtë vendim.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha